

## KONTRATË SHIT – BLERJE KUOTE

Sot, më datë 09/07/2024 (dymijë e njëzet e kater), Shitësi dhe Blerësi, ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuote me termat e mëposhtme:

**SHITËSI:** **ALAR Consulting Sh.p.k.** shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT L71312045T, me seli në TIRANE, Rruga “Donika Kastrioti”, Pallati nr. 8, kati 3, Apartamenti nr. 2/3, Tiranë përfaqësuar nga Administratori Z. Astrit Hana.

**BLERËSI:** **DIJON ALBANIA Sh.a.**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT K81805011P, me seli në TIRANE, Lagjja Farke e Madhe, Kompleksi i Vilave Barkea, Zona Kadastrale 1604, Farke, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Zj. Silvana Pashako.

### KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria Tregtare **ITALDRURI ELBASAN Sh.p.k.** është themeluar më datë 10/09/1993 dhe regjistruar me datë 01/07/1996 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombetare të Regjistrimit me nr. NIPT J62903222L.

Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 1.497.049.087 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e dyzet e nëntëmijë e tetëdhjetë e shtatë) Lekë, i ndare në 3 kuota të zotëruara nga Ortakët si vijon:

1. **Shoqëria DIJON ALBANIA Sh.a.**, e cila zotëron 64,33% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.
2. **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**, e cila zotëron 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.
3. **Shoqëria ALAR Consulting sh.p.k.**, e cila zotëron 17,6% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.

Ortaku ALAR Consulting sh.p.k., i cili zotëron 17,6% të kapitalit të shoqërisë dëshiron të tjetërsojë pjesën e tij të kapitalit që zotëron.

Me vendimin datë 08/07/2024, ortaku ALAR Consulting sh.p.k., ka vendosur të miratojë shitjen e 17.6 % të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin e shoqërisë **ITALDRURI ELBASAN sh.p.k** tek blerësi ortaku **DIJON ALBANIA Sh.a.**, për një çmim prej 3.600.000 Euro.

Me vendimin datë 08/07/2024, ortaku DIJON ALBANIA Sh.a., ka vendosur të miratojë blerjen e 17.6 % të kuotave në kapitalin e shoqërisë ITALDRURI ELBASAN sh.p.k të zotëruara nga shitesi ortaku ALAR Consulting sh.p.k., për një çmim prej 3.600.000 Euro.

Me shkresën nr.8596/3 Prot. Date 08/07/2024, ortaku Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka vendosur të miratojë rendin e ditës: Transferimin e 17.6 % të kapitalit që ortaku ALAR Consulting sh.p.k., zotëron në shoqërinë ITALDRURI ELBASAN sh.p.k. tek ortaku DIJON ALBANIA sh.a dhe deklaroi se nuk është e interesuar për blerjen e kësaj pjese të kapitalit, pra nuk ushtron të drejtën e parablerjes.

Me vendimin datë 09/07/2024, Asambleja e ortakëve të shoqërisë ITALDRURI ELBASAN sh.p.k ka vendosur të miratojë shitjen nga ALAR Consulting sh.p.k., të kuotës që zotëron në masën prej 17.6 % të kapitalit themeltar.

Duke qenë se të dy ortakët kanë rënë dakord për shitjen e kapitalit të shoqërisë si më sipër palët hartojnë dhe nënshkruajnë këtë kontratë shit-blerje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë sipas parashikimeve si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **OBJEKTI**

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të shoqërisë "ITALDRURI ELBASAN" sh.p.k në masën prej 17.6 % të kapitalit themeltar, që zotërohen nga Ortaku i shoqërisë, shoqëria ALAR Consulting sh.p.k., i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga ortaku shoqëria DIJON ALBANIA Sh.a., në cilësinë e blerësit.

## **Neni 2**

### **KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN**

Shitësi ALAR Consulting sh.p.k., humbet pronësinë mbi masën prej 17.6 % të kuotës së zotëruar prej tij duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi pjesën e shitur të kapitalit.

Blerësi DIJON ALBANIA Sh.a., bëhet pronar i kuotave në masën prej 17.6 % të kapitalit të shitur, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtij kapitali.

**Pronësia mbi kuotat do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.**

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë do të zotërohet si vijon:

1. **Shoqëria DIJON ALBANIA sh.a.**, do të zotëroj 81.93 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 1,226,532,316.98 Leke.



2. **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**, do të zotëroj 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 270,516,770.02 Leke.

**Neni 3**

**ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS**

Shitesi pranon se ka marre nga Bleresi ne menyre te plote te gjithë çmimin e blerjes te rene dakord ne vleren 3.600.000 Euro, dhe per kete arsye transferon ketu 17.6% te Kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Kapitalin e Shoqerise "ITALDRURI ELBASAN" Sh.p.k., ne pronesi te Bleresit.

**Neni 4**

**DISPOZITA TË FUNDIT**


Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.

Termat e kësaj kontrate, pasi u lexuan prej palëve kontraktuese, u gjetën sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë dhe ata e nënshkruajnë pa vërejtje.

**PALET**

**SHITËSI**

**ALAR Consulting shpk**





**BLERËSI**

**DIJON ALBANIA sha**

